



Raport vlerësimi mbi situatën aktuale të të rinjve punëkërkues në qytetin e Kukësit, Fierit dhe Durrësit

Tiranë, Shkurt 2020

Ky raport është bërë i mundur përmes mbështetjes së GIZ. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë mendimet e GIZ.

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie e shkurtër : Mbi projektin dhe objektivat e tij	3
I. SITUATA AKTUALE E PUNËSIMIT, PAPUNËSISË DHE FORMIMIT PROFESIONAL TË TË RINJVE.....	5
1.1 Të dhëna dhe statistika mbi punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve të papunë.....	5
1.2 Kuadri ligjor kombëtar.....	8
II.METODOLOGJIA E APLIKUAR	10
2.1 Qasja metodologjike	10
2.2 Angazhimi i palëve të interesuara dhe vështirësitë e hasura gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave	12
III. VLERËSIMI I NEVOJAVE TEK TË RINJTË E QYTETIT TË KUKËSIT, FIERIT DHE DURRËSIT	13
3.1 Vlerësim dhe gjetjtjet pas takimeve mbi situatën në Fier	13
3.2 Vlerësim dhe gjetjtjet pas takimeve mbi situatën në Durrës.....	16
3.3 Vlerësim dhe gjetjtjet pas takimeve mbi situatën në Kukës.....	17
IV. KONSTATIME DHE GJETJET E PËRGJITHSHME.....	18

Parathënie e shkurtër : Mbi projektin dhe objektivat e tij

Mbi projektin

Studimet dhe analizat statistikore lidhur me punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve, tregojnë se punësimi dhe vetëpunësimi i tyre, vazhdon të mbetet një problem në proces. Paralelisht me sa më sipër është edhe niveli i arsimit dhe formimit profesional të të rinjve.

Megjithëse të dhënat zyrtare tregojnë një rënie të lehtë të shkallës së papunësisë në të gjithë vendin nga 17.5% në 2015 në 13,7% (2017), papunësia e të rinjve është akoma në një nivel të lartë afërsisht 25% (2017).¹

Papunësia e fshehur dhe papunësia vazhdojnë të karakterizojnë tregun shqiptar të punës. Kjo situatë është gjithashtu një nga faktorët kryesorë që çon në një numër në rritje të njerëzve që emigrojnë. Shumë rajone në të gjithë vendin po humbasin gjithnjë e më shumë shanset për rritje ekonomike, një trend që ecën në të kundërt me zhvillimet e korridorit ekonomik Tiranë-Durrës. Ata pak sektorë ekonomikë që manifestojnë rritje nuk mund të gjenerojnë efekte të prekshme të punësimin. Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që llogaritin pjesën më të madhe të punësimin tregojnë një rritje të papërfillshme ekonomike. Investimet e huaja direkte janë të pakta dhe krijojnë pak mundësi punësimi. Në këtë situatë, arsimi profesional dhe formimi profesional i studentëve dhe kursantëve është përballur me mundësi të kufizuara punësimi, si në mënyrë cilësore ashtu edhe në mënyrë sasiore. Punësimi i fuqisë punëtore të aftë dhe të vetëpunësuarit në tregun shqiptar të punës, veçanërisht të të rinjve të aftë, është i papërshtatshëm dhe është kthyer në një çështje shumë të rëndësishme, për të ardhmen e vendit.²

Projekti i përgatitur për këtë qëllim synon të kontribuojë në uljen e në brezin më aktiv dhe në moshat më produktive, duke orjentuar grupet e synuara që të indentifikojnë dhe zbulojnë mundësi të reja në formën e vetëpunësimin. Ky grup i synuar me gra, të rinj, persona të rikthyer nga emigrimi dhe persona nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët janë praktikisht klientë të rregjistruar si të papunë pranë zyrave të punësimin në disa rajone më problematike si (Fier, Durrës dhe Kukës). Nëpërmjet projektin synohet që të përzgjidhen dhe të nisin procesin e identifikimit të mundësive për vetëpunësim në formën e iniciativave individuale, në zonat përkatëse. Në të njëjtën kohë nëpërmjet projektin synohet të stimulohet identifikimi dhe zhvillimin e aftësive të të rinjve dhe grupeve të tjera, të cilët arrijnë të paraqesin ide dhe mundësi potenciale për vetëpunësim, për të kthyer problemet e zonave në fjalë në mundësi për ndritjen dhe zhvillimin e bizneseve të vogla për të gjeneruar punësimin e të rinjve, me qëllim kryesor uljen e papunësisë në këtë shtresë të rëndësishme të shoqërisë shqiptare dhe krijimin e mundësive për parandalimin e emigrimit. Pas mbledhjes së nevojave të zonave në fjalë nga aktorë të ndryshëm, synohet identifikimi i grupeve të të rinjve që duan ti bashkohen projektin për

¹ Raporti Kombëtar i Vetëpunësimin 2018

² Raporti Kombëtar i Vetëpunësimin 2018

më tej në fazën e përzgjedhjes së llojit të veprimtarive ku do të vetëpunësohen dhe atë të trajnimit dhe përgatitjes së planeve të biznesit e deri në financimin e tyre. Vecantia e projektit është që financon deri dy iniciativa biznesi për çdo qark, nga tre qarqet e mësipërme. Në këto kushte, nëpërmjet projektit synohet që të shikohen mundësitë e zgjimit të iniciativave dhe nxitjen e vetëpunësimit nga të rinjtë si shtresa më aktive për të ardhmen e zonave në fjalë. Projekti nëpërmjet ekspertizës do të sigurojë jo përzgjedhjen e llojeve të biznesesve për vetëpunësimin e të rinjve, por edhe përgatitjen në bashkëpunim me të rinjtë të planeve të biznesit, për tju përshtatur më shumë nevojave të zonave përkatëse për të siguruar jetëgjatësinë e biznesit të drejtuar nga të rinjtë.

Objektivat konkrete të projektit janë:

Rritja e kapaciteteve të 50 të rinjve të papunë të moshës 19-34 vjeç (20 gra të reja, 15 të rinj dhe 15 të kthyer nga emigracioni) që janë regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të në Fier, Kukës dhe Durrës, për të rritur aftësinë e tyre për tregun e punës përmes masave të referimit dhe mbështetjes. Ndërhyrja synon të ketë këto objektiva specifike:

- ❖ Identifikimi, vlerësimi dhe regjistrimi i të rinjve të papunë, përfshirë edhe gratë e reja, të rinjtë e papunë nga grupet e pakicave të Romëve dhe Egjiptianëve, si dhe të kthyerit nga emigrimi, të regjistruar si punëkërkuar pranë zyrave të punësimit, të cilët janë të rregjistruar pranë zyrave të punësimit dhe janë në pritje të një pune. Gjithashtu, në këtë aspekt, është parashikuar që të bëhet një vlerësim i aftësive të këtyre të rinjve lidhur me nivelet dhe llojin e trajnimit, idetë dhe dëshirat që ata kanë lidhur me zhvillimin e zonës ku ata jetojnë dhe synimet që ideja e tyre duhet të arrijë për të zgjidhur problematika të pa mbuluara nga biznese të tjera egzistuese në zonë ose pjesë të pa mbuluara prej tyre për të zhvilluar idetë e tyre.
- ❖ Mbledhja e të dhënave mbi situatën dhe nevojat e bizneseve vendore, Zyrës së Punës, strukturave të qeverisjes vendore dhe projekteve përkatëse të GIZ dhe partnerëve të saj për identifikimin e të rinjve të papunë dhe të punëkërkuarve që kanë ndjekur trajnime profesionale. Sa i takon kësaj, në projekt janë parashikuar takime të vecanta me të gjithë aktorët lokalë, për të diskutuar mbi problematikën që projekti synon të arrijë, duke marrë në konsideratë këndvështrimin dhe informacionin e aktorëve të tjerë, me synimin jo vetëm të mbledhjes së informacionit dhe të dhënave, por edhe mbledhjen e ideve dhe mendimeve të tyre, pasi janë më pranë problematikës së zonave në fjalë. Të dhënat dhe idetë e aktorëve të tjerë si dhe të dhënat e mbledhura nga takimet me të rinjtë, do të analizohen dhe do të nxjerrin konkluzione që do të ndihmojnë ekspertët e projektit që të realizojnë objektivat e tij.
- ❖ Aktivizimi i të kthyerve nga emigracioni brenda komuniteteve të tyre në Fier, Kukës dhe Durrës duke rritur kapacitetet e tyre përmes masave të referimit dhe mbështetjes, që të zhvillojnë idetë e biznesit të tyre / bizneseve dhe idetë fillestare. Ky aspekt është i rëndësishëm, sepse ka persona të kthyer të cilët kanë krijuar eksperiencë në vendet ku kanë studiuar, janë trajnuar apo janë punësuar dhe kanë dëshirën për tu vetëpunësuar, por

kanë nevojë për një ekspertizë në aspektin financiar, ligjor dhe atë të biznesit. Aktivizimi i këtyre personave është një nga synimet e projektit për të ndihmuar dhe asistuar këtë grup që të dojë më tej dijet e përfituara në punësim ose atë në fushën e trajnimeve në periudhën e emigracionit. Zbulimi i tyre dhe ndihmesa e ofruar nga ekspertët e projektit krijon një mundësi për uljen e papunësisë në zonat në fjalë dhe heqjen e këtyre personave nga listat e punëkërkuesve të papunë në zyrat e punës.

- ❖ Përmirësimi i kapaciteteve të 50 të rinjve të papunë në Fier, Kukës dhe Durrës përmes trajnimeve, mentorimit dhe seancave hyrëse për të hartuar një ide biznesi social/ biznesi / ndërtimin e planit të biznesit dhe pajisjen e tyre me aftësitë e nevojshme për administrimin e një biznesi. Kjo fazë e projektit synon që pas identifikimit të grupit të të rinjve të fillojë procesi i trajnimit për të gjitha fazat e zhvillimit të një biznesi dhe më tej do të vijohet me procesin e mentorimit ndaj personave të cilët do të jenë ata që do të menaxhojnë keto biznese. Synimi i projektit është që të arrihet jo vetëm vetëpunësimi i tyre, por të synohet që të planifikohet edhe punësim i të rinjve të tjerë në këto iniciativa të reja, për të dhënë edhe një shembull ose një precedent pozitiv për kolegët e tyre të tjerë që nuk janë pjesë e projektit.
- ❖ Rritja e mundësisë së vetëpunësimit për të rinjtë e Fierit, Kukësit dhe Durrësit. Në zonat e përmendura si pasojë e emigracionit të brendshëm drejt qyteteve të mëdha, si dhe emigracionit përtej kufijëve janë lënë shumë hapësira dhe mundësi për të zhvilluar biznese të vogla ose të mesme, me qëllim zgjidhjen e problematikave të zonave në fjalë. Largimet dhe zhvendosjet kanë krijuar mundësi për zëvendësim dhe/ose përmirësim të shërbimeve në format e vetëpunësimit ose bizneseve të vogla, por që në fakt janë të nevojshme dhe deri diku të pazëvendësueshme. Në keto kushte nëpërmjet vetëpunësimit në sektorë të lënë pasdore ose në hapësirat e krijuara mund të zgjidhen problemet e papunësisë në grupet e të rinjve dhe grupeve të tjera të synuara nga projekti. Mundësitë që të rinjtë të vetëpunësohen janë, prandaj projekti synon që të zbulojë ato hapësira dhe probleme që zonat e mësipërme kanë, me qëllim që nevojat dhe kërkesat të plotësohen dhe të rinjtë aktivë dhe me iniciativë të vetëpunësohen.

I. SITUATA AKTUALE E PUNËSIMIT, PAPUNËSISË DHE FORMIMIT PROFESIONAL TË TË RINJVE

1. Të dhëna dhe statistika mbi punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve të papunë.

Gjatë viteve të fundit rritja ekonomike dhe nivelet e punësimin nuk kanë pasur një vijë të njëtrajtshme lineare, por kanë pësuar në mënyrë të vazhdueshme ulje dhe ngritje.

Edhe pse kuadri ligjor për mbrojtjen e investimeve është përmirësuar dhe ka pasur mbështetje për bizneset e reja, përsëri punësimi mbetet problem për shoqërinë shqiptare. Nga kjo situatë, të rinjtë, edhe pse janë pjesa më produktive dhe aktive e popullsisë, vuajnë pasojat e papunësisë

dhe mbi të gjitha mungesën e politikave që mbështesin fuqizimin dhe hapjen e bizneseve rinore dhe rrjedhimisht rrisin numrin e të rinjve të punësuar.³

Qëllimi i këtij objekti, pasuar dhe nga aktivitetet përkatëse, synon rritjen e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, përmirësimit të kuadrit ligjor, mbështetjes së programeve “start-up” me fokus sipërmarrjet rinore, zgjerimit të kurseve profesionale të ofruara nga shkollat e Aftësisit Profesional si dhe krijimit të konkurseve që nxisin idetë inovative.

Rritja e punësimit apo/dhe vetëpunësimit ngelet një nga sfidat socio-ekonomike më të rëndësishme në nivel kombëtar në Republikën e Shqipërisë. Përkrah analizës së tregut të punës në nivel kombëtar, për të vlerësuar mundësitë dhe pengesat me të cilat duhet të përballen individët për të gjetur një punë, është e rëndësishme që të studiohet tregu i punës edhe në nivel rajonal, duke marrë në konsideratë veçoritë që ekzistojnë në secilin prej rajoneve dhe që diktojnë jo vetëm norma të ndryshme të treguesve të punësimit, por edhe lloje të ndryshme të aktiviteteve ekonomike në të cilët individët punësohen. Shqipëria ka norma relativisht të larta të vetëpunësimit në raport me numrin total të të punësuarve, krahasuar kjo edhe me vendet e rajonit, ku për vitin 2017 kjo peshë llogaritet në 35.4% të të punësuarve në total. Referuar të dhënave më të fundit të tregut të forcave të punës në vend, Shqipëria karakterizohet nga një normë e lartë e popullsisë në moshë pune jashtë fuqisë punëtore, nivel i cili referuar vitit 2017 arrin normën e 33.2%.⁴

Gjetjet që kanë rezultuar në raportin kombëtar të vetëpunësimit janë mbështetur mbi analiza të detajuara të një sërë raportesh, strategjish dhe planesh zhvillimi si dhe në opinionin e një sërë ekspertësh të fushës. Për sa i përket disa nga gjetjeve më kryesore përmendim:

- ✦ Pësia e punëkërkesve të grupmoshës 20-34 vjeç ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit;
- ✦ Ka një diferencë të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës me bazë gjinore, diferencë e cila është shumë e theksuar sidomos tek kategoria e të vetëpunësuarve;
- ✦ Shqipëria karakterizohet nga një treg pune me diskriminim gjinor në paga;
- ✦ Ka mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, kjo më e theksuar për individët me arsim të lartë;
- ✦ Punësimi mes grupimit të ndërmarrjeve është në nivele të barabarta mes atyre të vogla dhe tyre të mëdha edhe pse grupi i parë përbën pjesën më të madhe të numrit të ndërmarrjeve;
- ✦ Integrimi i emigrantëve të kthyer në tregun e punës mbetet një problem i vazhdueshëm dhe kërkon masa konkrete për të kaluar këtë kategori nga ofrues të punës në kërkues të punës.

E rëndësishme është analiza e avantazheve krahasuese që ka çdo rajon, pasi këto avantazhe duhet të shihen si mundësitë potenciale ku të rinjtë duhet të synojnë të drejtohen në të ardhmen.

³ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020

⁴ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020

Reduktimi i papunësisë në përgjithësi dhe i të rinjve në veçanti, është sot sfida më e vështirë në nivel lokal, kombëtar dhe global. Kostot e papunësisë janë individuale, familjare, kombëtare dhe globale. Cënimi i kohezionit social nga niveli i lartë i papunësisë dhe i pabarazisë ushqen sot skeptikët dhe radikalët, prodhon pakënaqësi shoqërore dhe destabilizim politik. Në kushtet e periudhave të gjata me inflacion të ulët, rritja e punësimit është sot një prioritet i rëndësishëm shoqëror. Format e punësimit dhe tregjet potenciale të punës tentojnë të jenë nën dryshime dinamike të shpejta dhe të thella. Një prej tyre është edhe vetëpunësimi. Kjo është sot edhe sfida më e madhe e programeve të edukimit, trajnimit dhe ri-trajnimit, të cilat duhet të edukojnë dhe përgatisin individë që krijojnë biznes dhe jo thjesht punëkërkes.⁵

Trendet kryesore

Referuar të dhënave të AFP-së shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës ndjek një trend pothuajse konstant përgjatë viteve 2008 – 2017.

Në vitin 2008, pjesëmarrja ishte rreth 53% e individëve të aftë për punë, duke arritur nivelin maksimal në vitin 2011, me rreth 60%.

- ✓ Pjesëmarrja në forcat e punës është përkeqësuar në dy vitet në vazhdim, ku në vitin 2013 arrihet edhe shkalla më e ulët e pjesëmarrjes në forcat e punës për periudhën e marrë në shqyrtim, konkretisht 52.4%.
- ✓ Pas vitit 2013, ky tregues është përmirësuar vazhdimisht duke arritur në shkallën 58% në vitin 2017. Shkalla e punësimit ka ecur në të njëjtin trend me atë pjesëmarrjes në forcat e punës.
- ✓ Viti 2011 shënon vitin me shkallën më të lartë të punësimit gjatë periudhës 2008-2017, në një nivel prej 51.9%.
- ✓ Pas 2013, shkalla e punësimit është përmirësuar vit pas viti, duke shënuar 50.3% për vitin 2017. Shkalla e papunësisë ka ruajtur një trend pothuajse konstant përgjatë viteve 2008 – 2012, në intervalin e 13% – 14% dhe më pas ka filluar të rritet për dy vitet në vazhdim, duke arritur maksimumin në vitin 2014 me 17.5% për të filluar përsëri një trend ulës dhe në vitin 2017 ka arritur në nivelin e 13.7%.⁶

⁵ Raporti Kombëtar i Vetëpunësimit 2018

⁶ Raporti Kombëtar i vetëpunësimit 2018

Grafiku 1 Mbi treguesit e tregut të punës



7

1.2 Kuadri ligjor kombëtar

Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020 – “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt” ka nisur zbatimin që në fundin e vitit 2014. Objektivi kryesor i kësaj strategjie është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimin në vend dhe formimit profesional të forcës së punës me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë të gjithë ciklit të jetës. Strategjia ka në qendër të saj rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës dhe te sistemit të kualifikimeve.⁸

Kuadri ligjor në fushën e Ligjit të Punës është prezantuar parimisht nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, miratuar paraprakisht më 12.07.1995. Ndryshimet e fundit të Kodit të Punës në vitin 2015 u transpozuan rreth 16 direktiva të BE-së mbi ligjin e punës.

Ligji bazë në fushën e punësimin është Ligji Nr 7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimin” i ndryshuar. Qëllimi i këtij ligji është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht, nëpërmjet sigurimit që të ketë punë për të gjithë ata që kërkojnë punë, një punë e tillë të jetë sa më produktive që të jetë e mundur, të ketë

⁷ Marrë nga Raporti i Tregut të Punës 2018, Burimi INSTAT

⁸ Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020

liri në zgjedhjen e punës dhe mundësitë më të plota të mundshme për çdo person të punësuar, që të kualifikohet dhe të përdorë aftësitë dhe dhuntitë e tij në një punë ku ai është përshtatur siç duhet. Ky ligj shoqërohet nga një seri aktesh nënligjore që synojnë të bëjnë të mundur zbatimin sa më të mirë të tij. Në këto akte nënligjore janë parashikuar një seri politikash të reja, që synojnë punësimin e të rinjve, grupeve të marginalizuara, femrave të kthyer nga emigracioni etj.

Programet e nxitjes së punësimit administrohen dhe zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe kualifikimim, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontrakttojë subjekte të tjera publike, private apo shoqëri civile, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit. Kështu programet e nxitjes të parashikuara janë:

- programet e garancisë rinore, që janë programe të cilat po përdoren nga vende të ndryshme të Evropës gjatë tri viteve të fundit. Këto programe parashikojnë angazhimin e të rinjve të regjistruar si punëkërkuar të papunë, që brenda një periudhe disa mujore të angazhohen në një nga programet të cilat zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, si programet e nxitjes së punësimit për punësim të menjëhershëm, praktikant profesional, formim nëpërmjet punës, arsim apo formim profesional etj.

- programi “transport për në vendin e punës” i cili ka parashikuar rastet kur vendi i punës është larg vendbanimit të punëkërkuarit dhe për të mospenguar punësimin, ky program do të parashikojë mbështetje për transportin.

Programet e formimit profesional, si pjesë të programeve aktive të tregut të punës, janë parashikuar që ky program t’u shërbejë si punëkërkuarëve edhe punëdhënësve dhe realizohet nëpërmjet proceseve mësimore dhe kurseve të mësimin teoriko–praktike. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të jetë institucioni që zbaton programet e formimit profesional dhe do të ofrojë:

- kurse pa pagesë për punëkërkuarët e papunë;
- kurse me pagesë për persona që e kërkojnë një gjë të tillë;
- mjedise dhe mjete logjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.

Ligji Nr 145/2015 “Për punëkërkuarët e papunë” ka për qëllim realizimin e misionit të zyrave të punësimit për të ofruar sa më shumë mundësi punësimi dhe kualifikimi për punëkërkuarët e papunë, në mënyrë të veçantë për përfituesit e mbështetjes me të ardhura, për t’i integruar ata në tregun e punës. Nxitja e punësimit është ndër programet aktive që nëpërmjet sigurimit të punësimit të përkohshëm apo afatgjatë ndikon në kërkesën për punë duke reflektuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë. Përmes këtij programi Zyrat e Punësimit ndërhyjnë për të nxitur dhe mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës duke bashkëpunuar me punëdhënësit

dhe nëpërmjet subvencionimit të tyre. Kuadri strategjik i punësimit dhe aftësive synon zbatimin e masave dhe programeve me qëllim që:

- ✓ Të nxisë mundësitë për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme;
- ✓ Të ofrojë arsim dhe formim profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;
- ✓ Të nxisë përfshirjen sociale dhe kohezionin territorial;
- ✓ Të fuqizojë qeverisjen e tregut të punës dhe të sistemeve të kualifikimit.

II. METODOLOGJIA E APLIKUAR

Kapitulli II përshkruan qasjen metodologjike të këtij vlerësimi, duke parashtruar pyetjet kërkimore, qasjen për mbledhjen e të dhënave, aktorët e përfshirë, aktivitetet e zhvilluara, vështirësitë e hasura si dhe analizimin e të dhënave të përfutuara. Qendra ALTRI zhvilloi dy procese për mbledhjen e të dhënave për secilin grup interesi. Konkretisht:

1. Takimi informues me të rinjte punëkërkues në qytetin e Fierit, Durrësit dhe Kukësit si dhe procesin e anketimit;
2. Takim me aktorët e përfshirë si përfaqësues të bashkive, zyra të punës, bizneseve lokale dhe organizatat e shoqërisë civile.

2.1 Qasja metodologjike

Puna kërkimore u përqendrua në 6 drejtime kryesore:

1. Identifikimin e drejtpërdrejtë të nevojave, identifikimin e të rinjve potencialë, mbledhjen e informacionit të detajuar nga të rinjtë, me qëllim përcaktimin e nevojave dhe aftësive të tyre lidhur me mundësitë për vetëpunësim ose hapje të biznesi për të plotësuar nevoja të zonës ku ata jetojnë;
2. Identifikimin e drejtpërdrejtë të nevojave dhe mbledhjen e informacionit nga aktorët vendor në zonat përkatëse si zyra vendore të punësimit, bashkitë, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, mbi nevojat dhe problematikat e zonave përkatëse dhe mundësitë potenciale për nxitjen e iniciativave të të rinjve të papunë në vetëpunësim ose hapjen e bizneseve të reja;
3. Vlerësimin e situatës aktuale social-ekonomike të zonave në fjalë lidhur me punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve si dhe mbi mundësitë apo eksperiencat e suksesshme të cilat janë hasur në zonat e tyre;
4. Vlerësimin dhe analizimin e nevojave dhe të dhënave të mbledhura nga takimet e drejtpërdrejta me të rinjtë e papunë të përfshirë në takimet prezantuese të projektit dhe në takimet me ekspertet e projektit.
5. Vlerësimin e nevojave, informacionit dhe sugjerimeve të aktorëve vendorë të përfshirë në aktivitetet me ekspertët e projektit.

6. Konkluzione të nxjerra nga sa më sipër, për të përcaktuar mundësitë potenciale për zhvillimin e ideve të reja, përgatitjen e të rinjve potencialë dhe vijimësinë e aktiviteteve të parashikuara të projektit;

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme mbi situatën aktuale të punësimit, papunësisë, formimit profesional të të rinjve në Kukës, Fier dhe Durrës, u zhvilluan disa takime me aktorë të ndryshëm (zyrat vendore të punësimit, bashkitë, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe vete të rinjtë e përzgjedhur për tu bërë pjesë e këtij projekti) të cilët:

- ✓ Kanë të dhëna konkrete dhe statistika lidhur me të rinjtë e papunë në qarkun e Kukësit, Fierit, Durrësit;
- ✓ Kanë të dhëna konkrete dhe statistika mbi formimin profesional të të rinjve të papunë në qarqet përkatëse;
- ✓ Kanë të dhëna konkrete mbi kërkesat reale të tregut të punës;
- ✓ Mund të shërbejnë për punësimin e grupeve të të rinjve në qarqet përkatëse ose si mbështetje për hapjen e bizneseve për një pjesë të tyre.

Për të orientuar diskutimin për secilën kategori me të cilën u zhvilluan takimet u parapërgatitën prezantimet për projektin, qëllimin dhe objektivat e tij. Për mbledhjen e informacionit dhe nevojave u mendua ndarja në dy grupe të vecanta nga njeri-tjetri. Grupi i parë ishte grupi i të rinjve të papunë, ndërsa grupi i dytë ishte grup i përbërë nga aktorët e tjerë vendorë, si zyrat e punësimit, bizneset e qarkut, përfaqësues të bashkive dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në qarqet përkatëse.

Gjatë takimit me grupin e të rinjve në pjesën e parë të takimit u bë prezantimi i projektit dhe synimet e tij nëpërmjet një forme informimi dhe bashkëbisedimi. Më tej grupit të të rinjve ju drejtuan një seri pyetjesh orjentuese në formën e bashkëbisedimit, mbi nivelin arsimor, rregjistrimin si punëkërkyes, eksperiencën në punë, eksperiencën në trajnime apo formim profesional, emigracionin, përkatësinë në komunitetin Rom ose atë Egjiptian, .

Më pas u kalua në diskutime mbi problematikat dhe nevojat e punësimit në qarqet përkatëse nevojat e të rinjve, informacionin që ata kishin mbi strukturat shtetërore të specializuara për punësimin dhe formimin profesional, mbi dëshirat dhe planet e tyre për më tej, idetë që ata kishin mbi zonën ku jetonin. Më pas, për grupin e parë, atë të të rinjve, për të cilin ishin përgatitur pyetësorët përkatës u bë shpërndarja e pyetësorëve. Paraprakisht të rinjve pjesëmarrës në takime ju dhanë udhëzime dhe instruksione mbi plotësimin e pyetësorëve, ku u përcaktuan në mënyrë orjentuese dhe jo shteruese të gjitha pyetjet apo temat e diskutimit gjatë takimeve. Procesi i anketimit kishte për qëllim identifikimin e të rinjve dhe plotësimin e kushteve të pjesëmarrjes në projekt për të vijuar më tej, në fzat e tjera të projektit. Pyetjet ishin të strukturuar në mënyrë të tillë për të marrë sa më shumë informacion në lidhje me të shkuarën dhe eksperiencat e tyre, trajnimet, formimin profesional, mendimet dhe idetë për zonën ku jetonin dhe potencialin për të pasur dhe zhvilluar ide biznesi.

Pas përfundimit të takimeve me të rinjtë e zonave në fjalë, ishin programuar takimet me aktorët e tjerë në zonat përkatëse. Pjesëmarrësit të cilët ishin menduar të merrnin pjesë në takim, ishin

përfaqësues nga zyrat e punësimit, përfaqësues të bashkive, përfaqësues të bizneseve të zonës, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, të angazhuar në procese të ngjashme, ose veprimtaria e tyre lidhej drejtpërdrejt ose indirekt me punësimin ose formimin profesional të të rinjve.

Axhenda e këtyre takimeve ishte programuar që fillimisht të ftuarit të njiheshin me prezantimin mbi projektin dhe synimet e tij dhe në pjesën e dytë të kalohej në diskutime dhe bashkëbisedim të hapur për të nxjerrë informacionet mbi punësimin, formimin profesional, strategji ose dokumente të miratuara për zhvillimin ekonomik të zonave përkatëse, politikat vendore për punësimin, zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e të rinjve për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, problematikat e bizneseve lidhur me fuqinë punëtore, planet dhe investimet e tyre në zonat përkatëse, nevojat dhe informacione të tjera që lidheshin me mangësitë në zinxhirin e shërbimeve ose produkteve të zonës, si dhe mendime të tjera që aktorët të shpreheshin sipas këndvështrimit të tyre.

Gjatë kësaj faze të projektit u zhvilluan 6 takime. Nga 2 takime në cdo qark ku takimi i parë u zhvillua me të rinjtë dhe takimi i dytë u zhvillua me aktorët e tjerë të qarqeve Fier, Durrës dhe Kukës.

2.2 Angazhimi i palëve të interesuara dhe vështirësitë e hasura gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave

Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, palët e interesuara u ftuan të jenë pjesë e projektit nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në procesin e mbledhjes së të dhënave, në fushatën ndërgjegjësuere të të rinjve dhe në diskutime mbi temat e projektit.

Gjatë aktivitetit të parë të projektit u përfshinë një sërë aktorësh me të cilët u zhvilluan takime për të diskutuar lidhur me statistikën për numrin e punëkërkuësve të regjistruar në zyrat e punësimit për secilin nga qarqet, nivelin e arsimimit të tyre, llojet e punëve për të cilat ata kishin interes, llojet e punëve të kërkuara nga tregu për secilin qark, angazhimi i punëkërkuësve në kryerjen e kurseve për aftësimin profesional etj. Angazhimi dhe kontributi i pothuajse të gjithë aktorëve të përfshirë në projekt ka qenë maksimal.

Megjithatë, gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit/analizimit të tyre u vunë re disa vështirësi/problematika të cilat mund ti përmbledhim si më poshtë:

- ✓ Vështirësi u konstatuan në gjetjen dhe mbledhjen e të rinjve, por jo vetëm. Edhe nga aktorët e tjerë nuk u arrit një numër i madh pjesëmarrjeje, ndërkohë që zyrat e punësimit, përfaqësuesit e bashkive dhe organizatat e shoqërisë civile kishin më shumë pjesëmarrje dhe interes. U konstatua që në qarkun e Kukësit kishte mungesë interesimi nga përfaqësuesit e bizneseve;
- ✓ U konstatua mungesë e strategjive në qarkun e Kukësit dhe Durrësit për punësimin dhe vetëpunësimin në pjesën e qeverisjes vendore dhe përpjekjeve serioze për të ndërmjetësuar/orientuar punëkërkuësit, madje edhe atë grup të cilët kishin kryer kurse të aftësimi profesional, ndërkohë që në qarkun e Fierit strategjia e zhvillimit ishte e pa azhornuar.

Mungesa e planeve konkrete strategjike të zhvillimit dhe punësimit nga ana e Bashkive ose moszbatim në nivelin e duhur të tyre ishte një tjetër vështirësi në procesin e punësimit dhe vetëpunësimit të orjentuar dhe startegjik për zhvillimin e qarqeve përkatëse.

- ✓ Mungesa e stafeve dhe numri i vogël i personelit që angazhohej në procesin e punësimit dhe ndërmjetësimit në punë të rinjve, ishte një tjetër vështirësi e konstatuar gjatë kësaj faze të projektit.
- ✓ Gjatë takimeve u vërejt mungesë e informacioneve/statistikave alternative në disa raste ose vështirësi në marrjen e këtij informacioni, pasi në qarqet përkatëse kishte mungesa të zyrave private të punësimit dhe zyrat shtetërore të punësimit ishin i vetmi burim informacioni lidhur me alternativat për punësim;
- ✓ Punësimi në administratën shtetërore dhe atë vendore ishte synimi parësor i të rinjve që dëshironin të punësoheshin.
- ✓ Nga takimet rezultoi se kishte vështirësi dhe mungesë e mbështetjes për start-up-et;
- ✓ Mungesa e agjencive private të punësimit ose ndërmjetësimit ishte një nga vështirësitë e tjera për të rinjtë që nuk kishin një alternativë konkurruese për ofrimin e shërbimeve të punësimit ose ndërmjetësimit konkurruese me zyrat shtetërore të punësimit;
- ✓ Vështirësi u konstatuan edhe me problematika që lidhen me mentalitetin nga ana e punëkërkuësve (kryesisht lidhur me femrat) si dhe me tendencën e lartë të të rinjve për të emigruar, për qëllime shkollimi, trajnimi dhe punësimi, gjë që e vështirësoi takimin pasi një pjesë e tyre kishin synime të qarta për të emigruar, kjo u konstatua, sidomos në rrethin e Fierit.

III. VLERËSIMI I NEVOJAVE TEK TË RINJTË E QYTETIT TË KUKËSIT, FIERIT DHE DURRËSIT DHE REZULTATET ME AKTORËT E PËRFSHIRË NË FIER, DURRËS DHE KUKËS

3.1 Vlerësimi mbi situatën në Fier dhe rezultatet e takimit me aktorët e përfshirë

Sipas të dhënave të grumbulluara në kuadër të këtij projekti, situata aktuale lidhur me punëkërkuësit e papunë në qarkun e Fierit është si më poshtë:

Nga zyra e punës rezultojnë 5772 persona në total të regjistruar të papunë, ku 1594 prej të cilëve i përkasin grupmoshës 19-34 vjeç (51% femra) 151 prej të cilëve i përkasin komunitetit rom ose egjiptian 4 prej të cilëve i përkasin kategorisë së të kthyerve nga emigracioni; 418 prej totalit konsiderohen si punëkërkuës afatgjatë;

Mosha	Të papunë	Femra	Meshkuj	Komuniteti Rom/Egjypt	Nga emigracioni
19 -34vjeç	1954	51%	49%	151	4

Sa i takon arsimimit rezultojnë 152 punëkërkues me arsim të mesëm; 152 punëkërkues të pa-arsimuar; 25 punëkërkues me arsim të ciklit të ulët; 261 punëkërkues me arsim të lartë; Në totalin e punëkërkuesve 839 prej të cilëve janë pa profesion. Nga të dhënat e dhëna rezulton se përqindja e punësimit të punëkërkuesve të papunë të grupmoshës 19-34 vjeç është 40%.

Profesionet/zanatet të cilat kanë kryesisht punëkërkuesit e papunë në qarkun e Fierit janë inxhinier, jurist, mësues, ekonomist, infermier, menaxher, kuzhinier, kujdestare fëmijësh, rrobaqepësi, estetikë, hidraulik etj.

Nga të dhënat që vijnë nga bizneset në këtë qark rezulton se kërkesa më e lartë nga ana e tyre është për saldatorë të specializuar dhe profesionistë të specializuar për instalime elektrike në ndërtesa dhe ambiente biznesi.

Në rrethin e Fierit ka gjithashtu punëkërkues të kthyer nga emigrimi, por që ushqejnë idene për tu larguar përsëri nga vendi. Konstatohet se kthimi nga emigrimi bëhet vetëm nga ata individë të cilët nuk kanë marrë nga vendet ku kanë emigruar dokumentat për punësim ose qëndrim.

Të rinjtë nuk shohin afatgjatë procesin e formimit profesional megjithatë zanatet që po kërkojnë aktualisht janë kuzhinier dhe hidraulik, një pjesë e tyre pas bisedave u shprehën se këto profesione kërkojnë më shumë për të emigruar. Shumica janë me shkollë të mesme, por ka edhe nga ata me arsim 8 ose 9 vjeçar.


Gjatë takimeve në qarkun e Fierit u kërkua informacion nga të gjithë grupet e interesit të ftuara në takim, sidomos nga përfaqësuesit e shoqërisë civile mbi Projekte të tjera të ngjashme që janë në zbatim në këtë qark.

Gjetjet për rrethin e Fierit tregojnë se :

- ✓ Në qarkun e Fierit është në proces projekti “StartSmart” për vetëpunësimin, ku zbatuesit e projektit janë Zyra e Punës së bashku me organizatën “Sëiscontact”. Gjatë këtij programi për përfituesit nuk ka kritere përzgjedhje për aplikimet në program. Sëiscontact bën përzgjedhje për grupet e marxhinalizuara;
- ✓ Janë zhvilluar projekte të IDEAS ku ka patur shtatë raste të suksesshme të sponsorizuara me grante.
- ✓ Sipas përfaqësuesve të Bashkisë Fier, rezulton se ka disa projekte që mund të zhvillohen për emigrantët e rikthyer në Drizaj.
- ✓ Konstatohet se startupet si mundësi potenciale mbështeten me grante shumë të vogla dhe kryesisht në fillim të procesit. Vlerat me të cilat janë mbështetur janë deri në 500 Euro në formë grandesh dhe më pas një mbështetje e dytë deri në 300 Euro.
- ✓ Konstatohet se ka mungesë të lidhjes dhe interesit të Bashkisë Fier me fshatrat përreth zonës urbane, ndërkohë që Bashkia bashkëpunon vetëm me donatorët për vetëpunësimin.

- ✓ Sipas të dhënave që ka Bashkia Fierit, nuk ka të dhëna zyrtare për të rinjtë, pasi sipas tyre nuk ka një përkufizim zyrtar për të rinjtë. Ka një strategji për zhvillimin ekonomik dhe social të Fierit, por kjo strategji nuk është e përditësuar. Konstatohet se Bashkia nuk ka një sektor që të merret specifikisht me punësimin e të rinjve.
- ✓ Sipas përfaqësuesve të biznesit rezulton se ka një sistem të vetërregulluar familjar ose në bazë zonash vetëpunësimi në bujqësi, sipas nevojave të fshatrave. Ka një bashkëpunim të përmasave të vogla me zyrat e punësimit nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit ku janë punësuar të papunë të regjistruar, por ky bashkëpunim është sporadik dhe i pakonsiderueshëm për shkak të cilësive të punëkërkuësve të papunë. Sa i takon zanateve dhe profesioneve më të kërkuara nga tregu është e vështirë të nxirret ndonjë konkluzion i saktë, pasi në Fier nuk egzistojnë agjenci private punësimi dhe ndërmjetësimi për punë. Statistikat dalin vetëm nga zyrat shtetërore të punësimit, ndërkohë që besimi i punëkërkuësve se ato mund të ndihmojnë në punësimin e tyre është i ulët dhe rrjedhimisht të dhënat dhe statistikat nuk janë të plota.

Në kuadër të projektit u zhvilluan takime dhe u përzgjedhëm një grup të rinjsh (ne takim u paraqitën 24 persona që i përkasin grupmoshës nga 19-34 vjeç) për tu njohur me projektin dhe nëse do të shprehin interes mund të bëhen pjesë e projektit. Të gjithë të rinjtë të cilët morën pjesë në prezantimin dhe bashkëbisedimin me përfaqësuesit e projektit, pasi përfunduan me fazën e bashkëbisedimit dhe intervistave, të gjithë u aktivizuan në plotësimin e pyetësorit, nga i cili u nxorën rezultatet disa nga më të rëndësishmet renditen si më poshtë:



3.2 Vlerësimi mbi situatën në Durrës

3.2.1 Konstatimet dhe gjetjet në takimin me të rinjtë në Durrës

Gjatë takimit dhe bashkëbisedimit me të rinjtë e ftuar në takim rezultoi se të rinjtë kanë mungesa të theksuara me informacionin si në marrjen e tij edhe në dëshirën për ta kërkuar atë. Ka pasur disa raste nga të cilat nga projektet e PNUD-it kanë përfituar 10-15 të rinj lidhur me vetëpunësimin. Këto programe janë konsideruar të suksesshme. Ka pasur një projekt të menaxhuar nga Terre des Hommes për ngritje biznesi për komunitetin Rom të sponsorizuar nga GIZ, por rezultatet e tij nuk janë rregjistruar në zyrën e punësimin. Ka probleme me orientimin e të rinjve drejt profesioneve dhe kurseve të formimit profesional, e cila sjell që edhe pas përfundimit të kurseve të rinjtë përsëri mbeten të papunësuar.

Sipas rezultateve të analizuara nga pyetësi rezultoi se ka pasur probleme me plotësimin e pyetësorit dhe një pjesë e tyre nuk i janë përgjigjur të gjitha pyetjeve, prandaj edhe rezultatet e pyetësorit nuk janë të plota për të kryer një analizë të plotë apo për të nxjerrë një grafik të qartë. Gjithsesi nga analiza e pyetësorëve rezultoi se 24 të rinj dhe të reja (djem/burra dhe vajza/gra) ishin pjesëmarrës në takim dhe kanë plotësuar pyetësorin e dhënë nga Qendra ALTRI. Pas analizës së pyetësorit rezultoi se : 11 janë vajza dhe gra (45.83%) dhe 13 djem/burra (54.17%). Nga totali 11 persona i përkasin komunitetit rom. Nderkohë që asnjë person nuk ishte nga komuniteti egjiptian. Gjithashtu rezultoi se nga totali 5 persona janë kthyer rishtazi nga emigracioni. 13 persona me diploma arsimit 8/9 vjeçar dhe 3 me diploma të arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Nga totali rezultoi se 3 persona kanë kryer praktikë pune gjatë studimeve, 5 persona kanë diploma të përfituara jashtë sistemit shkollor, 2 persona janë aktualisht të punësuar dhe 10 persona e konsiderojnë veten të papunë, ndërkohë që rezultoi se 3 persona punësuar në sektorin privat të shërbimeve. Nga pyetësi rezultoi se 5 persona janë të gatshëm të vazhdojnë formimin profesional, 8 pohojnë se janë në kërkim të një pune. Asnjë person nuk është referuar pranë DIMAK. 2 persona shprehën se kanë ndjekur trajnim profesional gjatë kohës që janë në kërkim të punës, ndërkohë që, 4 persona e vlerësojnë gjendjen e tregut aspak të favorshme. Një nga konkluzinet e rëndësishme është se 2 persona kanë menduar të hapin biznesin e tyre dhe po ashtu 2 persona kanë një ide inovative për ta zhvilluar dhe janë të gatshëm ta konkretizojnë. Ndërkohë 1 person pohoi se ka njohuri për kërkesat ligjore dhe financiare për ngritjen e një biznesi dhe 3 persona pohojnë që nuk kanë njohuri për kërkesat ligjore dhe financiare për ngritjen e një biznesi. Në përfundim rezultoi se 18 persona janë të gatshëm për t'ju bashkuar iniciativës së zbatuar nga qendra ALTRI dhe të mbështetur nga programi ProSEED/GIZ Albania.

3.2.2 Konstatimet dhe gjetjet nga takimet e zhvilluara me aktorët e tjerë

Në zonën e Durrësit si edhe në zona të tjera të vendit një nga problemet që pengon punësimin është mentaliteti i punëkërkuësve. Sipas përfaqësuesve të biznesit, mendohet se ka potenciale për vetëpunësim në zonat e rurale, që konsistojnë në mbjelljen e kulturave bujqësore dhe bimëve medicinale. Në këtë zonë ka kurse të formimit profesional në fasoneri, hoteleri dhe pastrim


peshku. Nga bashkëbisedimi me aktorët rezulton se nga qeverisja vendore nuk ka plan aktual apo të parashikuar për vetëpunësimin e të rinjve, gjithashtu nuk ka një plan strategjik zhvillimi të zonës akoma. Të dhënat e ofruara nga zyra e punës japin disa shifra për papunësinë ku totali i të papunëve të rregjistruar rezulton si më poshtë : Jane 6000 punëkërkes të papunë në total kryesisht me arsim 9-vjecar. 2000 nga të cilët janë të grup moshës 19-34 vjec, nga të cilat rreth 50% janë femra, 200 janë nga komuniteti Rom.

Mosha	Të papunë	Femra	Meshkuj	Komuniteti Rom
19 -34 vjeç	2000	50 %	50%	200

3.3 Vlerësimi dhe gjetjet nga takimet e zhvilluara mbi situatën në Kukës

3.3.1 Nga takimi me të rinjtë

Për qarkun Kukës u përzgjedhën një grup të rinjsh (16 persona që i përkasin grupmoshës nga 19-34 vjeç) për tu bërë pjesë e projektit, të cilët së bashku me fazën e bashkëbisedimit dhe intervistave u aktivizuan në plotësimin e pyetësorit. Pas përpunimit të rezultateve nga pyetësori i plotësuar u nxorën rezultatet si më poshtë:



3.3.2 Vlerësimi dhe gjetjet nga takimi me aktorët e tjerë të përfshirë

Gjatë takimit me aktorët e përfshirë u prezantuan të dhëna të përgjithshme të grumbulluara nga të dhënat statistikore nga përfaqësuesit e zyrës së punës në Kukës paraqiten si më poshtë:

Rezultojnë 3393 persona në total të regjistruar të papunë, 117 prej të cilëve në moshën deri në 19 vjeç (50 femra); 395 prej të cilëve në moshën 20-24 (180 femra); 441 prej të cilëve në moshën 25-29 (252 femra); 374 prej të cilëve në moshën 29-34 (214 femra); 40 persona i përkasin komunitetit rom ose egjiptian (18 femra);

Mosha	Të papunë	Femra	Meshkuj	Komuniteti Rom/Egjipt	
deri në 19 vjeç	117	50	67	F	M
20-24	395	180	215		
25-29	441	252	189		
29-34	374	214	160	18	22

Sipas informacioneve të mbledhura nga takimi me aktorët e ftuar në takim profesionet/zanatet të cilat rezultojnë më të kërkuara nga punëdhënësit/bizneset në Kukës janë drejtues automjeti, punonjës të specializuar për punë në mobilieri, shitës, punonjës krahu të pakualifikuar. Programet e trajnimit profesional ndiqen përgjithësisht në fushat e parukerisë, kuzhinës, autoservisit dhe rrobaqepësisë.

Gjetjet në zonën e Kukësit rezultojnë se :

- ✓ Blegtoria dhe turizmi konstatohet se janë dy fusha punësimi që kanë mungesa në treg, specifikisht mund të përmendet guida turistike, ku bujtinat dhe subjektet e përfshira në turizmin malor deklarojnë që ka mungesa për staf të kualifikuar
- ✓ Bashkia e Kukësit përmend se përqindja e të rinjve në raport me popullsinë ka një rënie të madhe por nuk kanë ende shifra zyrtare për sa i përket emigrimit masiv.
- ✓ Në këtë qark vihet re një numër më i madh femrash të papuna dhe më arsim të ulët profesional.

Projektet në qarkun Kukës:

- ✓ U konstatua se nuk ka projekte apo programe shtetërore për mbështetjen e punësimit/vetëpunësimit.
- ✓ Në Kukës ka pasur vetëm një program nga UNDP për vetëpunësimin në sektorin e blegtorisë.

IV. KONSTATIME DHE GJETJET E PËRGJITHSHME

Nga analiza tërësore që është bërë në kuadër të kësaj faze të projektit, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

- ✓ Institucionet kanë mangësi që të orientojnë politikatat e tregut dhe punësimit në mbështetje të punëkërkesve të papunë të rinj

- ✓ Pamjaftushmëria e formimit profesional për edukimin e të rinjve me shprehinë bazë të punës dhe aftësisë të domosdoshme të sjelljes dhe komunikimit
- ✓ Mungesa e bashkëpunimit midis bizneseve vendase, zyrave të punës, qendrat e formimit profesional si dhe bashkive për realizimin e projekteve të përbashkëta për uljen e punëkërkuësve të papunë
- ✓ Mungesa dhe pamjaftueshmëri të informimit për të rinjtë punëkërkuës të papunë për kërkesat ligjore dhe financiare për krijimin dhe funksionimin e biznesit ose ndërmarrjeve sociale i cili tu ofrohet
- ✓ Përditësimi dhe zbatimi i politikave sociale ku përfshihen formimi profesional dhe nxitja e punësimit nëpërmjet programeve aktive të përmirësuara e të diversifikuara të tregut të punës, aksesit në shërbime etj, sidomos i grupeve të disavantazhuara, me qëllim sigurimin e barazisë në dinjitetin dhe të drejtat e tyre kërkon më shumë afërim pranë të rinjve dhe gjetja e mënyrave eficiente të shpërndarjes së informacionit.
- ✓ Nevoja e përmirësimit dhe zgjerimit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale si dhe në zonat të cilat kanë probleme të theksuara sociale dhe ekonomike
- ✓ Nxitja e hapjes së Agjencive Private të punësimit dhe ndërmjetësimit për punësim dhe orjentim në tregun lokal të punës.
- ✓ Gjatë takimeve në rrethin e Fierit u konstatua se shërbimi i pastrimit është një mundësi potenciale për orjentimin e të rinjve me pak aftësi, pasi ka kërkesë nga tregu i bizneseve dhe i familjarëve. Për këtë shërbim ka mundësi që të rinjtë të organizohen edhe në ndërmarrje sociale, për të përfituar edhe më shumë mbështetje nga legjislacioni në fuqi dhe donatorë të ndryshëm. Gjithashtu gjatë atkimit në këtë qytet u konstatua se ka nevojë për disa shërbime të transportit për produktet bujqësore të fshatrave për rreth qytetit të Fierit për të mbledhur dhe sjellë për ato familje që nuk kanë mundësi të sigurojnë transportin drejt tregjeve apo bizneseve të vogla.
- ✓ Gjatë takimeve në qytetin e Durrësit u konstatua se si raste potenciale për vetëpunësim ishte mundësia e shitjes së robave të përdorura, pasi norma e fitimit konsiderohej tërheqëse në këtë lloj biznesi. Po ashtu edhe në këtë qytet shërbimi i pastrimit ishte një mundësi potenciale ashtu si edhe në Fier. Guidat turistike të drejtuara nga të rinjtë që mund të shërbenin për turistët e huaj, në qytetin e Durrësit dhe rrethinat e tij, u konstatuan se ishin një mundësi tjetër potenciale vetëpunësimi të të rinjve. Sektori bujqësor, blektoria dhe furnizimi rezultoi si një tjetër mundësi për të tentuar në vetëpunësim dhe zhvillimin e një biznesi për të rinjtë e këtyre zonave.
- ✓ Gjatë takimeve në qytetin e Kukësit rezultoi se mentaliteti kryesor i të rinjve për punësimin mbetet institucionet publike shtetërore dhe vendore, si dhe emigrimi jashtë Shqipërisë ose drejt kryeqytetit, ndërkohë që alternativat e tjera nuk merreshin shumë në konsideratë nga të rinjtë, kjo për shkak edhe të pagave të ulta dhe nivelit të pazhvilluar të bizneseve të zonës. Nga të gjithë aktorët thujase u konfirmua se potenciali për vetëpunësim është dhe mbetet sektori bujqësor në zonat përreth qytetit të Kukësit, por

edhe ky potencial vështirësohej për shkak të kushteve të mungesës së ujit për vaditjen e produkteve bujqësore.